

VENDIM
Nr.505, datë 13.5.2009

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE TË DISA
NGASTRAVE TË EKONOMIVE PYJORE “MALI I KAKARIQIT”, LEZHË, DHE “DAJÇ-
VELIPOJË”, SHKODËR, QË DO TË PËRDOREN NGA “SEASIF GROUP”, SHPK, PËR
NDËRTIM FABRIKE ÇIMENTOJE DHE KARIERE GURI GËLQEROR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet në ngastrat 1 e 2 të ekonomisë pyjore “Mali i Kakariqit”, Lezhë, dhe në ngastrat 40 e 41 të ekonomisë pyjore “Dajç-Velipojë”, Shkodër, që do të përdoren nga “Seasif Group”, sh.p.k., për karrierë guri gëlqeror, me sipërfaqe 80,3 (tetëdhjetë presje tre) ha, dhe për ndërtim fabrike çimentoje, 16,7 (gjashtëmbëdhjetë presje shtatë) ha, gjithsej 97 (nëntëdhjetë e shtatë) ha, të hiqen nga fondi pyjor e kullor kombëtar dhe të çregjistrohen nga kadastra kombëtare e pyjeve dhe kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pasi të përcaktojnë në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit pyjor dhe kullor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të bëjnë çregjistrimin e sipërfaqeve nga kategoria “Tokë e zënë, kullotë” dhe “Tokë e zënë, pyll” dhe t’i regjistrojnë në sipërfaqe inproduktive (karrierë guri gëlqeror dhe truall për ndërtim fabrike), në përputhje me pikën 9, të vendimit nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.

3. Vlera e kësaj sipërfaqeje pyjore dhe kullorë të paguhet nga “Seasif Group”, sh.p.k., sipas akteve ligjore në fuqi. Llogaritja e tarifave për heqjen nga fondi pyjor të bëhet sipas lidhjes 4, që i bashkëlidhet vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

4. “Seasif Group”, sh.p.k.-ja, brenda 3 (tre) viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të pyllëzojë, me fondet e veta, 53 (pesëdhjetë e tre) ha me pyje, si dhe të përmirësojë 38 (tridhjetë e tetë) ha kullotë, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor.

Lloji i drurëve, që do të mbillen, dhe grafiku i mbjelljeve të caktohen nga drejtoritë përkatëse të shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, të cilat i ndjekin mbjelljet deri në marrjen në dorëzim, me procesverbal, të sipërfaqes së pyllëzuar, sipas marrëveshjes, që do të lidhin me kërkesin.

4. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, komuna Balldre e qarkut të Lezhës, e komuna Bushat e qarkut të Shkodrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1

PËRDORIMI I TERRITORIT SIPAS KADASTRËS PYJORE DHE ZRPP

Sipas kadastrës së pyjeve dhe kullotave							Sipas ZRPP		Obje kti
Ekonomia pyjore/kullo sore	Ngastr a, n/ngast ra	Përdori mi i territor it	Forma e qeveri mit	Funksi oni	Pronësia	Sip. që hiqe t ha	Përdori mi territor it	Sip. ha	Obje kti
Ep Mali i Kakarriqit	1	Pyll	Shkurre	Prodhue s	Kom.Balld ren	21.9	Kullotë	21.9	Karrie rë guri gëlqer or
Ep Mali i Kakarriqit	2	Pyll	Shkurre	Prodhue s	Kom.Balld ren	11.1	Kullotë	11.1	Karrie rë guri gëlqer or
Ep Dajç – Velipojë	40	Pyll	Cungis hte	Prodhue s	Kom.Bush at	8.9	Kullotë	8.9	Karrie rë guri gëlqer or
Ep Dajç – Velipojë	40	Pyll	Cungis hte	Prodhue	Kom.Bush at	10.7	Kullotë	10.7	Fabrik a
Ep Dajç – Velipojë	41	Kullotë	Ska	Ska	Kom.Bush at	38.4	Kullotë	38.4	Karrie rë guri gëlqer or
Jashtë fondit pyjor/kulloso r					Kom.Bush at	0.0	Kullotë	6.0	Fabrik a
TOTALI						91.0		97.0	

